

Duke iu referuar shkresës suaj 2705/1 datë 17/08/2015 dëshirojmë të saktësojmë sa më poshtë vijon:

1. Shkresa juaj e sipërcituar me përjashtim të një tentative për të devijuar realisht problemin që ne ju kemi parashtruar nuk shpreh ndonjë qëllim tjetër për të ndryshuar vendimin që institucioni juaj ka marrë në shkelje të hapur të ligjit.
2. Në këtë shkresë, ju po vetë, keni pohuar se vlefshmëria e certifikatës që i takon periudhës 2010-2014 në bazë të vendimit të Këshillit Kombëtar të UFSH-së përfundon më datë 30/06/2015 e për rrjedhojë farmacisti duhet të jetë i pajisur me dokumentin e ri përkatës për ushtrimin e profesionit, i cili ligjërisht lëshohet vetëm nga UFSH.
3. Po në këtë shkresë, ju i referoheni një njoftimi të dalë nga QKEV-ja, në lidhje me datën e provimit të ricertifikimit. Ju rikujtojmë se këtij provimi do ti nënshtrohen ata farmacistë të cilët nuk e kanë përmbyshur me sukses procesin e ricertifikimit pra nuk janë ricertifikuar nga UFSH dhe kjo përbën një shkelje ligjore nga ana juaj. Pasi të japin këtë provim dhe të dalin me sukses prej tij, është kompetencë po e UFSH-së t'i pajisë këta persona me leje të ushtrimit të profesionit. Kontratat të cilat lidhen nga



data 01/07/2015 e në vazhdim do të lidhen me ato subjekte të cilat e kanë përmbyllur me sukses procesin e ricertifikimit dhe janë pajisur me lejën e re të ushtrimit të profesionit me formën e së cilës ne iu kemi njohur.

4. Shkresa Nr.420 datë 25/06/2015 s'ka si përmbajtje dhe as si qëllim kërkesë që institucioni ynë i bën institucionit tuaj për shtyrje vlefshmërie certifikate pasi kjo është kompetencë vetëm e Këshillit Kombëtar të UFSH-së por përmbajtja e saj ka qenë thjesht vec një njoftim mbi një vendim të Këshillit Kombëtar.
5. Bazuar në ligjin Nr. 9150, datë 30.10.2003 **“Për Urdhrin e Farmacistëve të Shqipërisë”** i ndryshuar; nenit, 2, pika 2, shkronja a) **“Urdhri i Farmacistëve, bën regjistrimin e farmacistëve në një regjistër të veçantë”**; shkronja e) **“Jep dhe heq të drejtën vetjake për ushtrimin e këtij profesioni”**; nenit 6, pika 1. **“Asnjë individ nuk mund ta ushtrojë profesionin e farmacistit në Republikën e Shqipërisë, pa qenë anëtar i Urdhrit të Farmacistëve”**.

Ju rikujtojmë se të drejtën e ushtrimit të profesionit të farmacistit në Republikën e Shqipërisë e ustrojnë vetëm individët të cilët kanë përmbushur detyrimin ligjor të ricertifikimit dhe janë pajisur nga UFSH me certifikatën e re nga data 01/07/2015. Cdo individ i cili nuk është pajisur me certifikatën e re, nuk ka të drejtë të ushtrojë profesionin e farmacistit.

Në qoftë se i referohemi përsëri përmbajtjes së shkresës suaj dhe në qoftë se qëllimi juaj real do të ishte shërbimi ndaj pacientit ky nuk mund të bëhet me venime të marra nga ana juaj të cilat nuk janë të bazuara në ligj e për më shumë nuk janë kompetencë e institucionit tuaj.

Nisur nga sa më sipër për të mos rënë dhe në përsëritje të atyre që kemi përcjellë dhe në shkresat e mëparshme dëshirojmë t'u bëjmë me dije se cdo njohje nga ana juaj e dokumentit zyrtar (leje ushtrimit të profesionit) të lëshuar nga UFSH të cilës i ka



humbur vlefshmëria (më datë 30/06/2015) përbën shkelje ligjore dhe tejkalim kompetencash nga ana juaj, ndaj ne jemi të vendosur që për zgjidhjen e tij të ndjekim të gjitha rrugët ligjore.

**PRESIDENTE**

**Diana Toma**

- Duke u referuar shkresës suaj 3705/1 datë 17/06/2015 dhe shumicë të aktuarve të më poshtë vijon:
1. Shkresa juaj e sipërcituar me përjashtim të një tërësie për të devijuar realisht problemin që ne ju kemi parashtruar nuk shpreh asnjë qëllim tjetër për të ndryshuar vendimin që institucioni juaj ka marrë në vijim të ligjit.
  2. Në këtë shkresë, ju pa vetë, keni pohuar se vlefshmëria e certifikatës që i takon periudhës 2010-2014 në bazë të vendimit të Këshillit Kombëtar të UFSH-së përfaqëson më datë 30/06/2015 e për ryedhejë farmacisti duhet të pajisur me dokumentin e ri përkatës për ushtrimin e profesionit, i cili ligjërisht tërhiqet vetëm nga UFSH.
  3. Pa në këtë shkresë, ju i referoheni një njoftimi të datë nga QKEV-ja, në lidhje me datën e provimit të ricertifikimit. Ju rikujtojmë se këtu provimi do të nënshtrohen ato farmacistë të cilët nuk e kanë përmbushur me sukses procedurën e ricertifikimit pra nuk janë ricertifikuar nga UFSH dhe kjo përbën një shkelje ligjore nga ana juaj. Pasi të japin këtë provim dhe të dalin me sukses prej tij, është kompetencë po e UFSH-së të pajisë këta persona me leje të ushtrimit të profesionit të tyre të rihet lidhen nga